



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 337 /2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Prizren, e që ka të bëjë me vendosjen e posterave para fillimit të fushatës zgjedhore në seancën e mbajtur me datë 08.12.2010 mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

ARSYETIM

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka bërë shkeljen e Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe Rregullën Zgjedhore “Kodi të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”, të cilët para fushatës zgjedhore kanë vendosur reklamat e subjektit të tyre politik, për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë.

Më 06 Dhjetor 2010, PZAP ka pranuar një ankesë nga subjektit politik PDK në Prizren, duke pretenduar se me datën 30.11.2010 në ora 15:00 subjekti politik AAK ka bërë shkeljen e nenit 32.5 dhe nenit 33 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe Rregullën Zgjedhore “Kodi të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”, duke vendosur reklamat e subjektit të tyre politik para fushatës zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotokopjen e fotografisë që gjendet në rrugën Prizren – Gjakovë.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të shqyrtojë këtë ankesë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore në bazë të dispozitave ligjore të aplikueshme.

LZP me dispozitën e nenit 44, përcaktohen aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore në mënyrat e specifikuar me atë dispozitë ligjore.

LZP me dispozitën e nenit 33 dhe Rregullorja e Zgjedhjeve Nr 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, me dispozitën e nenit 4, u ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre, të caktuara me këto dispozita ligjore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Meqenëse veprimet e pretenduara nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, vlerësohet në pajtim me dispozitat e cituara ligjore se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, për çka edhe vlerësohet se ankesa është si e palejuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 337/2010 më datën 08.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Muhamet Rexha

